



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.273/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZL. Anr.273/2025 e datës 19.10.2025, parashtruar nga Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datë 19.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, në të cilën thekson se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në teren. Parashtruesja e ankesës dyshon për parregullsi gjatë numërimit të votave nga QNR, veçanërisht në klasat: 1702/01, 1701/02, 1705/01, 1706/06, 1706/07, 1707/01, 1705/01, 1712/01, 1714/01, 1715/01, 1722/01, 1722/02, 1722/03, 1725/05, 1726/01. E njëjta kërkon verifikim dhe hapje të kutive për saktësi në këto qendra të votimit.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se lidhur me pretendimet e palës ankuese thekson se Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/1+228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, I<QZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do W, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV, Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga I<QZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për mospërputhje të rezultatit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara ne ankesë tani për tani mbeten ne nivel te supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklaratimin e disa personave – votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, numër personal, nënshkrimin e tyre si dhe numër të telefonit të tyre, Sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragraf 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjë sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë e votës.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonje dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, apo mbështetjen-në pohimet të qytetarëve (votuesve), me te cilën do te vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.273/2025 datë 22.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



A.A.nr.98/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së kandidates për Asamble Komunale në Komunën e Pejës, Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 24.10.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET ankesa e kandidates për Asamble Komunale në Komunën e Pejës, Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës, Priset vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025, dhe çështja i kthehet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në rivendosje.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa, ZL. Anr.273/2025 e datës 19.10.2025, parashtruar nga Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidatja për Asamble Komunale në Komunën e Pejës, Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konesion



ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën si të bazuar, të anuloi vendimin e PZAP ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025, dhe të urdhërojë verifikimin dhe hapjen e kutive të votimit në qendrat ku janë evidentuar mospërputhje.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur nga kandidatja për asamble komunale Gentiana Bajrami Atashi, ka kërkuar nga gjykata që ankesa A.A.nr.97/2025, e datës 23.10.2025, paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-it, ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 19.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, në të cilën thekson se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në terren. Parashtruesja e ankesës dyshon për parregullsi gjatë numërimit të votave nga QNR, veçanërisht në klasat: 1702/01, 1701/02, 1705/01, 1706/06, 1706/07, 1707/01, 1705/01, 1712/01, 1714/01, 1715/01, 1722/01, 1722/02, 1722/03, 1725/05, 1726/01. E njëjta kërkon verifikim dhe hapje të kutive për saktësi në këto qendra të votimit.

Në përgjigjen në ankesë të ushtruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: lidhur me pretendimet e palës ankuese thekson se Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV, Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve



nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Lidhur me pretendimet e palës ankuese për mospërputhje të rezultatit zgjedhor, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e mospërputhjes së rezultateve zgjedhore.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.273/2025, të datës 22.10.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidates për asamble komunale Gentiana Bajrami Atashi, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se: Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën të ankuses Gentiana Bajrami Atashi, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Pejë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga dëshmitarët në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklarinimin e disa personave votuesve, të identifikuar me emër dhe mbiemër, numër personal, nënshkrimin e tyre si dhe numër të telefonit të tyre, Sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragraf 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon



fshehtësinë votës. Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, apo mbështetjen-në pohimet të qytetarëve (votuesve), me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime. Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me refuzimin e ankesës së parashtruar nga kandidatja për asamble komunale në Komunën e Pejës, Gentiana Bajrami Atashi nga radhët e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i aplikueshëm sipas Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 01/2025 të PZAP-së për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, dhe si rezultat i kësaj nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, duke aplikuar në mënyrë të gabuar edhe të drejtën materiale, duke e refuzuar ankesën e parashtruar nga kandidatja për asamble komunale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret PZAP, gabimisht ka vendosur me refuzimin e ankesës së parashtruar nga kandidatja për asamble komunale, për faktin se:



PZAP-i nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme dhe bindëse në raport me pretendimet ankimore, madje arsyet janë kundërthënëse në vetvete, pasi në njërin anë potencon se është refuzuar ankesa për shkak të mungesës së dëshmive ndërsa në anën tjetër potencon se ato që janë dorëzuar nga ankuesja përbëjnë cenim të lirisë dhe fshehtësisë së votës. Arsyetimi në raport me pretendimet ankimore është i pa qëndrueshëm, jo i mjaftueshëm sepse nuk është dhënë përgjigje në raport me secilin pretendim e madje pretendimeve kryesore iu ka jep përgjigje pa hetim fare, pra nuk mund të anashkalohet fakti i dëshmive që janë në dosjen e lëndës sepse në proces zgjedhor dëshmi tjera palët nuk kanë mundësi të sigurojnë për shkak të pamundësisë së qasjes në Qendrën e Numërimit.

Arsyetimi i PZAP-it në raport me përgjigjen e KQZ-së se me rastin e deponimit të dëshmive nga ana e ankueses po cenohet fshehtësia e votës nuk qëndron. Me nenin 4 pika 1.3 të LZP-së përcaktohet se: *“liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjëse për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim”*, andaj me rastin e deponimit të dëshmive si formulari i deklaramit vullnetar të personave si dëshmitar në asnjë mënyrë nuk e cenon lirinë e as fshehtësinë e votës. Nga interpretimi i dispozitës në fjalë votuesi me vetë dëshirë ka mundësi që pas procesit të votimit ta bëjë publike votën, por nuk ka mundësi askush tjetër ta detyrojë votuesin që kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën, ose arsyet për mos votim. Kur kësaj ia shtojmë faktin se mënyra e hetimit të parregullësive të pretenduara në Qendrën e Numërimit është përmes hapjes së kutive të votimit, dëshmitë e vetme që pala ka mundësi të i siguroj janë deklaramet e qytetarëve por deklarime të vullnetshme. Qytetarët e nënshkruar në formular, formularin e kanë deponuar në institucionin përkatës që garanton integritetin e procesit zgjedhor PZAP dhe nuk e kanë bërë publike, andaj me qëllim të hetimit dhe verifikimit të pretendimeve dhe për hirë të ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor këto paraqesin dëshmi për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm.

Si rrjedhojë, gjykata vlerëson se PZAP me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankueses nuk ka vepruar në pajtim me nenin 117 [Procedurat e PZAP-së] par.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *“PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtuar”*, si dhe nenin 15 [Zhvillimi i Hetimeve të Materialit Zgjedhor] par.3, pika 3.1 të Rregullores 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave, ku përcaktohet se: *“3. Duke u bazuar në ankesat e paraqitura për*



shkeljet e supozuara në QNR, QKN, PZAP-i, mund t'i kryej këto hetime: 3.1 hetimi i kutisë së votimit."

Të metat e mësipërme janë të atij karakteri që e bëjnë të pamundur që Gjykata Supreme të vendos ndryshe, për faktin se me nenin 117 të LZP-së, është në kompetencë të PZAP-it, që gjatë vendosjes për një ankesë të shqyrtojë dhe hetojë të gjitha dëshmitë relevante, andaj në rastin konkret është dashur që të siguroj dhe hetoj materialin zgjedhor, veçanërisht kutitë e votimit, që nënkupton vërtetimin e dëshmive që paraqesin provë të rëndësishme për të vlerësuar ecurinë e procesit zgjedhor në secilën qendër votimi të pretenduar.

Në rivendosje, PZAP, udhëzohet që të shqyrtoj edhe njëherë pretendimet ankimore të ankueses, provat e deponuara dhe të procedojë tutje në hetimin e këtyre pretendimeve përkatëse që të sigurojë që mos të cenohet integriteti i procesit zgjedhor dhe secila votë të shkojë në destinimin e synuar dhe mos të ketë devijim të vullnetit të qytetarëve.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.98/2025, datë 24.10.2025.

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA OF KOSOVA
KËSHILLI GYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI I KËSHILLIT GYQËSOR TË KOSOVËS



GYJKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-98/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënies së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određenom vremenu u svom stan radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stan - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____

Shkaku i refuzimit të marrjes
Razlog odbijanja prijmea

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebre precrtati)

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

ARTIMENDUR

Numri i shtojcave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdjuemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij)
Popis primioca ili lica koje je
pismo primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analabët ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzuesi, duke shkruar shkaktun pse marrësin nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac neispisan ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač,
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.